

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSI NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--	---	--

17 maj 2012

SCC – 09 – 0043

Paditësit

1. **N.S., XX**
2. **P.S., XX**
3. **A.C., XX**

Të përfaqësuar nga XX, avokat nga XX

Kundër

Të Paditurit

1. **XX, NSH, XX**
2. **XX, SH.A., XX**

Kolegji i Specializuar i përbërë nga Alfred Graf von Keyserlingk, Kryesues i Kolegjit, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, Gjyqtarë, lëshon këtë

A K T G J Y K I M

- 1. Padia refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Paditësit obligohen që bashkërisht të paguajnë tarifat gjyqësore në shumë prej 50 euro.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Më 27 mars 2009, Paditësit parashtruan padi në Dhomën e Posaçme në bazë të Vendimit nr. 11/63 të Komunës së Prishtinës të datës 24 janar 1964 për këmbim të tokës. Në bazë të këtij vendimi, ngastrat kadastrale nr. 1502, 1325, 1372/4, 1320, 1350, 1483 dhe 1484 në Çagllavicë ishin shpronësuar nga paraardhësi i tyre në dobi të NSH-së XX (paraardhëse e NSH-së XX). Paditësit pohojnë se në këmbim të pronave të lartpërmendura paraardhësit të tyre i ishin darë ngastrat kadastrale nr.236, 337, 373, 239, 301 dhe 235. Paditësit kërkuan që këto ngastra, tani t'u ndahen atyre. Atë kërkuan edhe kompensim për shpenzimet procedurale.

Paditësi deklaron se gjatë procedurës për vërtetimin e gjendjes faktike nga një Komision në Komunën e Çagllavicës në bazë të vendimit për komasacion, në prani të pasardhësit ligjor të V.S. u konstatua si vijon:

N.S., i biri i të ndjerit V.S., është posedues i ngastrës kadastrale 337; L.S., i biri i të ndjerit V.S., është posedues i ngastrës kadastrale 236; P.C., i biri i të ndjerit V.S., është posedues i ngastrave kadastrale 299 dhe 273 në vend të 235 që fillimisht i ishte ndarë V.S. Paditësit dorëzuan Protokollet nga procedura e lartpërmendur të datës 25

tetor 1989. Ato deklarojnë se Paditësi i dytë P.S. është pasardhësi ligjor i L.S. the Paditësja e tretë A.C. është pasardhësja ligjore e P.C.

Supozohet se asnjëra nga ngastrat e mësipërme nuk u është dhënë ndonjëherë Paditësve apo paraardhësve të tyre.

Më 18 tetor 2010 padia iu dërgua AKP-së si administruese e të Paditurve. Në mbrojtjen në padi të ushtruar më 17 nëntor 2010 AKP-ja në emër të të Paditurve deklaroi se padia duhet të refuzohet si e papranueshme ose, ndryshe, si e pabazuar. Të Paditurit argumentuan se Paditësit nuk ofruan argumente ligjore në padi, nuk paraqitën prova materiale, nuk dëshmuan legjitimitetin e tyre aktiv (mungesa e vendimeve të trashëgimisë) si dhe nuk i dhanë njoftimin paraprak agjencisë. Më tej, vendimi i kundërshtuar do të jetë përfundimtar pasi që asnjë shqyrtim ligjor nuk parashihet me Ligjin për Shfrytëzimin e Tokës Bujqësore (OG RPFJ 43/59). Prandaj, nuk ka bazë ligjore për kthimin e pronës.

Të Paditurit deklaruan se ata e kanë fituar pronën në bazë të parashkrimit fitues (neni 28 i LMTHP).

Më 1 shkurt 2011 Paditësit e ndryshuan padinë, si bazë ligjore ata dhanë nenin 37 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (RSFJ 6/80) dhe kërkuan përmbarimin e vendimit për shpronësim.

Të Paditurit deklaruan se kjo padi është e pabazuar sepse ky ligj ishte miratuar në vitin 1980 dhe nuk aplikohet për kontratat e vitit 1964.

Në seancën dëgjimore të mbajtur më 6 prill 2011, palët qëndruan prapa deklaratave të tyre të mëparshme, Paditësit ndryshuan padinë duke kërkuar ngastrat zëvendësuese për ato që janë në pronësi private. I Padituri i dytë dorëzoi se padia duhet të refuzohet, por pranoi që Paditësit u dëmtuan për shkak se nuk u përmbarua vendimi i shpronësimit.

Në seancën dëgjimore të mbajtur më 19 prill 2012, Paditësit sqaruan se prona subjekt i padisë është prona që i është ndarë paraardhësit të tyre në bazë të vendimit për komasacion të vitit 1964, d.m.th. ngastrat nr.235, 236 dhe 337, dhe se kjo pronë asnjëherë nuk iu transferua atyre apo paraardhësit të tyre.

Arsyetimi ligjor

1. Padia është e pabazuar.

a:

Kjo tanimë rezulton nga fakti se Paditësit nuk dëshmuan faktin e kontestuar se ata janë të vetmit trashëgimtarë të të ndjerit V.S. Gjykata nuk mundet thjeshtë të supozojë se është kështu dhe se dhe nuk është për t'u dëshmuar me paraqitjen e certifikatave të vdekjes së Č.S. (i njohur edhe si V.S.), L.S. dhe P.C. dhe certifikatat e lindjes së N.S., P.S. dhe A.C. Ata mund të jenë motra e vëllezër ose Paditësit mund të kenë hequr dorë nga trashëgimia e tyre. Pozita e paditësve si trashëgimtarë duhet të vërtetohet, nëse kundërshtohet si në këtë lëndë. Paditësve disa herë u ishte dhënë mundësia që të ofrojnë prova siç është Aktvendimi i Trashëgimisë dhe ishin paralajmëruar për pasojat. Siç u shpjegoi gjyqtari Paditësve të cilët janë të përfaqësuar nga avokati,

certifikatat e lindjet dhe të vdekjes nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar trashëgiminë.

b:

Pasi që padia nuk mund të pranohet sepse trashëgimia nuk është dëshmuar, gjykata në këtë rast nuk ka për të vendosur nëse transferimi i pronësisë në vitin 1964 ishte i vlefshëm sipas ligjit jugosllav dhe mbetet i vlefshëm sipas ligjit në fuqi në Kosovë. Nëse bëhet fjalë për të dyja rastet, Padiësit, duke marrë parasysh se një ditë do të dëshmohet pozita e tyre si trashëgimtarë, do të kompensohen vetëm pasi që ligjvënësi kosovar të ketë miratuar Ligjin mbi Rikthimin që do të mbulonte rastin e tyre. Një ligj i tillë tani për tani nuk ekziston. Në lidhje me këtë i mbetet ligjvënësit që të respektojë Propozimin Gjithëpërfshirës të Martti Ahtisaari-t për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës - sipas nenit 143 të Kushtetutës së Kosovës që është menjëherë në fuqi dhe madje që zë vendin e vetë Kushtetutës - i cili në mënyrë eksplicite e përmend kërkesën që rikthimi i pronës duhet të adresohet.

Shpenzimet

Në bazë të nenit 12 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme dhe në pajtim me Rregullat Plotësuese Procedurale në lidhje me Taksat Gjyqësore, të Dhomës së Posaçme, që janë në fuqi nga data 13 dhjetor 2010, tarifat e Dhomës në bazë të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/02 (ADJ) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë si vijon:

Për paditë me vlerë në shumë prej 5001 deri në 10000 euro (neni 10.1): 50 €

Për lëshimin e Aktgjykimit (neni 10.12): është e njëjta si më lartë.

Vlera e padisë vendoset nga gjykata në shumën që kalon 5001 euro. Prandaj, shuma e tarifave Gjyqësore është 100 €.

Shpenzimet e procedurës barten nga pala e pasuksesshme, në këtë rast nga Padiësit. Padiësit tanimë kanë paguar shumën prej 50 €, kështu që Padiësit do të paguajnë në Dhomën e Posaçme shumën tjetër prej 50 €.

I Padiësi nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për kompensim të shpenzimeve të veta të procedurës dhe pasi që i Padiësi përfaqësohet nga avokati i vet, i Padiësi nuk gëzon të drejtën që të marrë kompensim për tarifat e arsyeshme të avokatit.

Këshillë ligjore

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet Ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'i dërgohet edhe palës tjetër dhe të dorëzohet tek Trupi Gjyqësor **nga Ankuesi** brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Ankesave dëshminë se e ka dërguar Ankesën edhe tek pala tjetër.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur Ankuesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

Kolegji i Ankesave e refuzon ankesën si të papranueshme nëse Ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

I Padituri mund të ushtrojë përgjigje tek Kolegji i Ankesave brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek ankuesi dhe tek pala tjetër.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Ankesave dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek Ankuesi dhe tek Kolegji i Ankesave.

Alfred Graf von Keyserlingk, Kryesues i Kolegjit

[nënshkruar]

Urdhër i brendshëm: ky aktvendim t'u dërgohet palëve